

KONTRATË SHITJE PJSËSH
TË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË TREGTARE
“DIRECTA” SHPK (SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA)

Në Tiranë, sot më datë 24.01.2022 (dy mijë e dymijë e njëzetë e dy), ne palët e mëposhtme:

PALA SHITËSE

Pier Luigi Massa, atësia Giancarlo, amësia Fernanda, datëlindja 15.05.1973, lindur në Frassinoro, banues në Itali, në adresën: Via Marcom 3/1 Cadelbosco di sotto Reggio Emilia, titullar i pasaportës italiane me nr. **YB4846918**, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 04.05.2019 e vlefshme deri më 03.05.2029.

PALA BLERËSE

Gabriele Marzano, atësia Rosario, datëlindja 27.11.1963, lindur në Mesoraca, banues në Via Gorizia, Reggio Nell Emilia Itali titullar i pasaportës me nr. YB4020463, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 29.11.2018 e vlefshme deri më 28.11.2028.

Shtetasit janë madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, të cilët me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar përpilojmë këtë kontratë shitje pjesësh të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare “DIRECTA” shpk, me kushtet si më poshtë vijon:

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Pala shitëse **Pier Luigi Massa** është ortak në shoqërinë Shoqëria “DIRECTA” shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS **M12114010F**, datë 14/09/2021 me seli në Tiranë, me adresë: “Njësia Bashkiake” Nr. 9, Rr. “Abdulla Keta”, Hyrja Nr. 1, Godina Me Nr. Pasurie 9/145b, Z.K. 1842, Pala shitëse, ortak u **Pier Luigi Massa** është zotërues i 1,00 pjese të kapitalit themeltar të shoqërisë, me pjesëmarrje në përqindje 100,00 % të pjesëve të kapitalit themeltar e barabartë me 100 000,00 lekë.





Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000,00 lekë (njëqindmijë) dhe është i ndarë në 1,00 pjesë (nje).

Pala shitëse **Pier Luigi Massa** dëshiron t’i shesë palës blerëse të gjithë pjesën e tij prej 100, 00 % me vlerë 100 000, 00 lekë, që zotëron në kapitalin e shoqërisë, duke u larguar vetë si ortak i shoqërisë “DIRECTA” shpk.

Gabriele Marzano, me blerjen nga pala shitëse të 100, 00 % të kapitalit themeltar bëhet ortak e shoqërisë “DIRECTA” shpk dhe zotëruese i 1 pjese në shoqëri, me pjesëmarrje në përqindje 100,00 % .

NENI 2

ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

Pala shitëse, shet të gjithë pjesën e vet prej 100, 00 %, që zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë kundrejt çmimit 100 000,00 lekë (njëqindmijë).

Pala shitëse deklaron se është likuajduar nga pala blerëse për shumën prej 100 000,00 lekë (njëqindmijë, që përbën çmimin e shitjes dhe se nuk ka asnjë pretendim as sot e as në të ardhmen.

NENI 3

TRANSFERIMI KAPITALIT

E drejta e pronësisë mbi kuotat që pala shitëse zotëron dhe ia shet palës blerëse, i kalon palës blerëse në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Pala shitëse i dorëzon blerësit të gjitha dokumentat, deklaratat, ose certifikatat e nevojshme për përfundimin e transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar në favor të blerësit dhe për regjistrimin e këtij transferimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Në momentin e transferimit të pjesëve palës blerëse, kjo e fundit bëhet ortakë e vetmë e shoqërisë dhe zotëruese e 1,00 pjesë, me pjesëmarrje në përqindje 100,00 % (njëqind përqind) kurse shitësi largohet si ortak i shoqërisë.

NENI 4

DEKLARATA DHE GARANCI

Pala shitëse deklaron dhe garanton blerësin për sa më poshtë vijon:

Pala shitëse është pronare e ligjshme e pjesëve që blihen nga blerësi, të cilat janë plotësisht të nënshkruara dhe të paguara plotësisht;

Shoqëria ka dorëzuar të gjitha deklaratimet e raportimet e tatimeve që kërkohen të dorëzohen sipas ligjit dhe ka paguar të gjitha vlerësimet tatimore, tarifat dhe detyrime të tjera shtetërore për shoqërinë, pasurinë e të ardhurat e saj, që sipas ligjit janë të detyrueshme për t'u paguar;

Shoqëria nuk është në shkelje të ndonjë marrëveshjeje me të cilën është palë;

Shoqëria nuk është palë, as nuk është në dijeni të ndonjë rreziku për ndjekje gjyqësore, arbitrazhi, apo administrative, rezultati i së cilës mund të kishte efekt material negativ për blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar.

NENI 5

DETYRIMET TATIMORE

Pala blerëse **Gabriele Marzano**, blen të gjithë kapitalin që **Pier Luigi Massa**, zotëron në shoqëri prej 100,00 % të kapitalit themeltar si më sipër, me gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të bilancit të shoqërisë deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 6

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me këtë kontratë, ose çdo marrëveshje tjetër, ose dokument të zbatuar midis palëve për zbatimin e kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, përndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis palëve, në lidhje me çështjet që trajton dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë me gojë apo me shkrim, midis palëve.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTOREGIURATO
0698193399

Pavlefshmëria ose pabazueshmëria e njërës nga dispozitat e kësaj kontrate nuk do të çenojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një marrëveshje ligjërish të vlefshme, që korrespondon sa më shumë të jetë e mundur me synimet e palëve.

NENI 7

NJOFTIMET

Të gjitha njoftimet dhe komunikime mes palëve do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen si të dhëna në mënyrë të rregullt nëse i dorëzohen në dorë, i dërgohen me postë të regjistruar ose me faks palës në adresën e paracaktuar nga palët.

NENI 8

DISPOZITA E FUNDIT


Kjo kontratë është nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe me të njëjtën vlerë secila, në bazë të nenit 705 e vijues të Kodit Civil, si edhe të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Kontrata nënshkruhet me vullnetin tonë të lirë, të plotë e të pavesuar.

PALËT


SHITËSI

Pier Luigi Massa



BLERËSI


Gabriele Marzano

MARZANO - GABRIELE


Perkthyesi i pranishem I pranishëm perkthyesi **Klodian Kovaçi**, atësia Petrit, amësia Françeskina, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë E Dibrës; Nd. 398; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1005; Tiranë, lindur më 10/09/1980, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 035688090 dhe nr. personal I00910100W. Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë.

Perkthyesi i pranishem

Klodian Kovaçi



KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
 0698193399

